



Asambleja  
01.Nr.IV  
Deçan,dt.29.04.2022

### PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.29.04.2022.

Në mbledhje ishin prezent: 26 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtive komunale.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, z.Hajdar Sutaj.

1. Për Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit finanziar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2022.
3. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Muzeut në Deçan,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e IV-të të rregullt të Kuvendit duke i përvendosur pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje marrin pjesë 26 antarë të Kuvendit (mungon me arsyen Faruk Hasanramaj).

Kryesuesi- e prezantoj rendin e punës të propozuar me ftesë, i njëjti miratohet njëzëri.

Mon Selmonaj-thot se i kam tri pyetje, për të cilat kërkoj sqarim në Të ndryshme.

Kryesuesi- thot se mbledhjen e kaluar kemi thënë, pyetjet të parashtronë me shkrim dhe të dorëzohen 5 ditë para mbledhjes.

Hyri Dobrunaj- thot se sa ju përket pyetjeve, është mirë të bëhen përpara në mënyrë që të lehtësohen puna e kuvendit dhe ato të dërgohen në formë elektronike te sekretaresha e kryesuesit.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj- sqaron se pyetjet e parashtruan nga anëtarët e kuvendit mund të bëhen sot këtu në mbledhje dhe në çdo kohë, nëse ne si ekzekutiv jemi të përgatitur përgjigje ua kthejmë menjëherë në mbledhje, përndryshe nëse kerkohet përgaditje për pyetje të caktuar, përgjigja kthehet mbledhjen e radhës.

Florim Mataj- thotë, në fund të seancës, në pikën Të ndryshme, e kemi të drejtën ti bëjmë pyetjet.

I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Mon Selmonaj-thot se nuk kam vërejtje, por Orgesi pat kërkua transmetim live të seancave të kuvendit dhe arsyja ime pse kërkoj të realizohet kjo kërkesë dhe seancat e kuverndit të transmetohen live është sepse është lakuar emri im nga një zyrtar i komunës, lidhur me diskutimin tim në mbledhjen e kaluar, është hera e parë qe 5 vite që jam në kuvend që lakohet emri im si asamblist, per ate kërkoj trasnmetim te seancave live që mos të ketë mundësi manipulimi askush.

Kryetari i Komunës-ka kërkua edhe pak sqarime shtesë në lidhje me kete çështje nga Moni.

Florim Mataj-thot kërkesa ime është që të vazhdojmë me rend të ditës, në të ndryshme duhet të ngriten këto tema.

Teuta Neziraj-në lidhje me procesverbalin thot se vazhdimisht po kemi vërejtje në lidhje me procesverbalin, vërejte te fq.6-te Zyra e Kuvendit- rregullimi i veturave-kërkon sqarim, diskutimi im është shkruar fjali pa kuptim ka thënë ajo.

Faton Selmanaj-thot se e kam ngritë si kërkesë edhe mbledhjen e kaluar dhe prap e përsëris, që nuk është në rregull që të na vjen ftesa për mbledhje të KPF-së dhe ftesa e kuvendit për një herë, kërkesa ime ka thënë ai është që ftesa për mbledhje të KPF-së të vjen një javë përpara.

Hyri Dobrunaj-thot se nuk është hera e parë që kemi vërejtje në procesverbal, obligim i juaji është dhe ju duhet me kriju kushte për mbajtje të mbledhjeve të kuvendit, edhe na kemi vërejtje në

procesverbal sepse nuk po përfshihet ajo që po themi faktikisht, mirëpo unë besoj se së shpejti do të ndërmerren masa për krijimin e kushteve për mbajtjen e mbledhjeve në sallë .

Arjan Dobraj- thot nëse kemi vërejtje te procesverbali ti bëjmë ato, të folim vetëm rreth procesverbalit dhe mos të dalim te pika, Të ndryshme.

Orges Tafilaj-thot se është mirë që diskutimi të më shkruhet ashtu si e them, në vazhdim ka bërë vërejtje: te fq. Par në fund duhet të jetë, me çfarë kriteresh është bërë emërimi i bordit të Higjenës, në fq.4 lidhur me diskutimin e parafolësit të shtohet teksti ”dhe të ndalohet një gjuhë e tillë” fq.5 të ceket se pyetjet i janë drejtuar drejtorisë përkatëse, është një rast në reportin financiar që nuk ka të dhëna të sakta as të faturimit as kujt ju ka bërë pagesa, fq.7 kam thane rregullorja është shumë e mirë dhe uroj që Deçani me investimet kapitale të , fq.8 në fund të vazhdohet fjalia “dhe kërkon kjo pikë të diskutohet ma vonë gjatë realizimit”.

Faton Selmanaj-vërejtje, në fq.8 duhet te jete” pse duhet dy dizajnues me qenë, fq.11. çka përkon me detyrimet e KelKosit”.

Kryesuesi- ka thënë se për momentin nuk kemi kushte për transmetim të seancave live.

Miratohet njëzëri ( 26 vota) procesverbali me vërejtjet e anëtarëve të kuvendit, me ndryshime dhe plotësimë, për çdo njërin te fjala e vet.

II. Shqyrtimi i reportit financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2022.

Kryesuesi- e ka prezantu reportin financiar për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2022, pastaj e ka hapë debatin rrith tij.

Hyri Dobrunaj- thot, sa i përket reportit financiar asgjë nuk ka ndryshu, zyra e kryetarit për tre muaj dreka dhe darka mbi 15.000 euro dhe ne anen tjeter mos me pase mundesi me kriju kushte per punë në mbledhje të kuvendit, në KPF na kanë thënë se në këtë shumë paguhen edhe drekat për klubet e sportit por nëse vazhdon kështu me këtë trend të shpenzimeve, deri në fund të vitit do të arrinë shifra 100.000 euro dreka dhe darka, pastaj ka cekë shpenzimet si, buxheti i shpenzuar me përmbarues, shërbime kontraktuese pyet çka quani ju, cili është shërbimi që kryen Veton Binakaj, qiraja për ndërtesa pyet çfar ndërtesa kemi na me qera, shpenzimet te karburantet skandaloze dhe është për te ardhur keq, janë shpenzime shum të larta, dhe në fund është raport skandaloz sipas meje ka thënë ajo.

Kryetari –pyet, përgjigjen e doni tash apo në fund për të gjithë diskutantët, për në fund ishte disponimi në sallë.

Mon Selmonaj-Te Zyra e kryearit 15,280 euro dreka zyrtare-a kini naj shpjegim për këte, në rapport nuk është përfshi mobilimi i tri zyreve të zyrtarëve komunal përfshi këtu zyrën e kryesuesit dhe siç e dini çdo blerje duhet ta ketë një kontrate, çka nënkupton me Paisje tjera pyet.

Orges Tafilaj- thot se gjendja nuk ka ndryshu nga raporti vjetorë, kam ba pyetje edhe atëherë por nuk kam marrë përgjigje, a ka person që paguhet pa bërë asgjë, a ka person me kontratë në vepër që është i afërt me zyrtarët komunal, pastaj ka cekë shpenzimet e karburanteve në shuma të larta dreka dhe darka, paratë që merren me vendime gjyqësore gjë që dëmton investimet kapitale që kishin pasë mundësi të bëhen në Komunën tonë, shpenzimet përrymë dhe pagesat e shumta për mbeturina, në fund meqenëse janë bërë shumë pagesa që tejkalon planifikimin buxhetor, ka shtruar pyetjen, meqenëse janë bërë shumë pagesa që tejkalon planifikimin buxhetor a ka planifikim të rrjedhës së parasë apo paguhen mjetet si minden aty ku gjinden në buxhet.

Florim Mataj-kam kërkua nga drejtoresha edhe në KPF që të na ipet një arsyetim ku kanë shku të gjitha këto mjete.

Vatan Istrefaj- pyet, pse mungojnë shum emra të studentëve që kanë përfitua bursë, sqarim për këtë. Drejtoresha e buxhetit, znj.Dafina Cacaj- ka thënë se shumica e mjeteve të shpenzuara në tre mujorin e parë janë borgje nga viti i kaluar, arsyaja ka qenë pse nuk ka pasë buxhet ma herët, drekat janë fatura të akumuluara nga viti i kaluar që janë bërë shpenzim në këtë periudhë, me vendim të kryetarit janë hjakë shujtat, Veton Binakaj është punëtorë me kontratë në vepër, për vendime gjyqësore nuk është në dorë tonë por ata i marrin mjetet ku i gjejnë, për bursa të studentëve- nuk kanë hy në sistem të gjithë për një herë por tash krejtë i kanë marrë bursat.

Faton Selmanaj-pyet, faturë furizim me ushqim –furnitorë Mërgim Iberhysaj B.I, kërkon sqarim çka ka qu ai aty kur dihet me çfar biznesi merret ai.

Drejtoresha përgjigjet se bënë furnizim te Shtëpia e të retarduarve.

Kryesuesi-e mbylli debatin rreth raportit duke kërkuar që shpenzimet të ulen aq sa është e mundur.

III. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Muzeut në Deçan,

Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj e hapi debatin rreth saj.

Hyri Dobrunaj-thot se e kemi debatuar edhe në KPF dhe e kemi përkrahur, mirëpo kérkesa jonë ka qenë që të futet edhe një nen i cili parashev hapjen gjirologarisë së Muzeut.

Arjan Dobraj-edhe grupi i AAK-së, si grupi ma i madh në kuvend e vlerësojmë si një statut të mirë dhe e përkrahim ate.

Teuta Neziraj- thot se është një dokument me rëndësi, jam pro këtij statuti, vetëm te zgjedhja e drejtorit të Muzeut një vit përvojë pune është pak, propozoj që të shtohen vitet e përvojës së punës te zgjedhja e drejtorit.

Miftar Ahmetxhekaj-te referencat ligjore te preambula ishte dashtë të ceket saktë, te neni 3.1 duhet të jetë data e themelimit 31.03.2022,03, dilema ime është te neni 5.3-Pasuria dhe objekti dhe këtu kérkoj që të sqarohet çka kuptojmë me objekt dhe pasuri, dhe kishte qenë mirë që te objekti të sqarohet që është Kulla ose ndërtesa. Neni 9.1 shërbimet me pagesë dhe falas, zakonisht në muze shërbimet falas nuk ka prandaj propozoj që teksti “dhe falas” të fshihet, në fund për shkak se është institucion duhet të ketë llogari rrjedhëse, nisur nga kjo propozoj që të futet neni që parashev se Muzeu ka llogarinë e vet rrjedhëse.

Miratohet në parim me propozimet e anëtarëve për plotësimet dhe ndryshime të Statutit të Muzeut, i nejti në procedurë të mëtutjeshme i nënshtronhet diksutimit publik.

IV.Të ndryshme.

Pyetje për mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Deçanit, të thirrur për dt.29 prill 2022, nga

Yllarta Thaqi drejtuar drejtorit, Izet Zenuni.

1. Siç edhe mund të jeni të informuar, momentalisht rruga Deçan – Llukë e Epërme (që hynë në kategorinë e rrugëve kryesore, sepse lidhë shumë fshatra) me gjatësi afro 2 km është dëmtuar thuajse tërësisht.
  - A keni planifikuar ta asfaltoni këtë segment rrugorë? (pavarësisht që kjo rrugë konsiderohet si kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, kjo rrugë është në territorin e komunës tonë, frekuentohet nga mijë qytetarë te asaj zone, të cilët edhe nuk mund ta dine së kompetence e kujt është, por e mbajnë përgjegjës komunën, ne si asamblistë dhe kryetarin Ramosaj). Cilat janë veprimet që keni ndërmarrë ose që do të ndërmerreni që kjo rrugë sa më shpejt të rregullohet?
  - Nëse mund të ketë vonesë të procedurave tenderues për asfaltim, qoftë nga Ministria apo Komuna, a keni mundësi ta asfaltoni në kuadër të kontratës për mirëmbajtje? Apo a keni mundësi urgjente që të paktën sa më shpejt ti sanoni gropat e mëdha të krijuar në këtë rrugë, e që rezikojnë të shkaktojnë edhe aksidente trafiku?
  - Poashtu edhe për dëmtimet e asfaltit gjatë prerjes nga KEDS dhe „Hidrodrini“ ku vetëm e kanë përfundu punën e tyre pa u lodh për pasojat qe i lenë pas në brendi te fshatit Llukë e Epërme, përgjatë rrugës kryesore janë 4 vende të tillë të cilat kanë shkaktuar edhe aksidente e besoi se probleme te tillë kanë edhe pjesa më e madhe e vendbanimeve në komunën tonë.
  - Një pyetje e tillë është edhe për gropat e krijuar ne qendër të Deçanit (tek rrethe rrrotullimi në qendër) çka dhe kur?
2. Siç jeni të informuar një nga rrugët me aksidentet me të mëdha në trafik, është rruga nga Deçani, deri tek fshati Pozhar, pyetja është:
  - A keni arritur të gjeni zgjidhje për ndërtimin e rrathë – rrrotullimit tek udhëkryqi te kanali (përkatësisht vendi ku bëhet degëzimi i rrugës kryesore me rrugën “Elez Geci e Maxhun Berisha”?)
  - A e keni mundësi që ti vendoseni tre pengesa (nga asfalti, pasi që është kérkesë e gjithë qytetarëve të asaj zone) ne tri udhëkryqet e rrugës “Elez Geci e Maxhun Berisha” përkatësisht

në pjesën e poshtme të udhëkryqit ne Llukë të Epërme, tek udhëkryqi në pjesën e poshtme tek lagjja Tahirukaj në Llukë të Epërme dhe në pjesën e poshtme të udhëkryqi në Pozhar.

Vendosja e këtyre pengesave është mase e domosdoshme, pasi siç i keni edhe raportet e policisë, ne këto pjesë çdo javë ka aksidente, madje fatkeqësisht edhe me fatalitet (nëse mund të thuhet që ka pengës nga Ministria, nuk mund të jetë valide, i askujt e aq më pak i Ministrisë, pasi që ka shumë rrugë regionale në Kosovë që ka pengesa të tilla, madje edhe rruga tranzit, Llukë- Carrabreg)

3.A mund të na informoni se deri ku ka arritur procedurat për implementimin e projektit te asfaltimeve të gjitha rrugëve dhe rrugicave të mbeturë në gjithë territorin e Deçanit, atë qe ju e quani "Loti 3" e që i përfshin edhe rrugët e rrugicat e fshatit nga vijë unë (Llukë e Epërme)

- Kur pritet të filloj?
- Kur pritet të përfundoj?

4.A mund të na informoni në çfarë faze është implementimi i projektit të elektrifikimit të rrugëve kryesore në fshatra (duke përfshirë edhe fshatin prej nga vi unë, Llukë e Epërme)

- Deri në çfarë faze është realizu?
- Kur pritet të filloj pjesa e mbetur?
- Dhe kur pritet të përfundoj?

Kryesuesi ka thënë meqenëse nuk qenka Izeti këtu, mund ta shtyejmë këtë çështje.

Miftar Ahmetxhekaj-për shkak të procedurës, pyetjet është mirë të shtrohen në fillim të mbledhjes, pajtohem me Kryetarin këtu që përgjigjet mund të bëhen në të njejtën mbledhje ose të shtyhen për seancën e ardhshme.

Kryetari i Komunës- sqaron se ka qenë praktikë në këtë Asamble që pyetjet e anëtarëve të Kuvendit janë bërë në fillim të mbledhjes atëherë kur është prezantuar rendi i punës dhe në fund të mbledhjes janë dhënë përgjigjet në pikën Të ndryshme, dhe është mirë që pyetjet të parashtronë kurë prezantonohet rendi i ditës, procesverbali i mbledhjes përfshinë përafërsishtatë çka duhet me thanë dikush në mbledhje.

Mon Selmonaj-thot se pajtohem me Kryetarin prandaj në fillim të mbledhjes i paraqita tri pyetjet e mijë:1. Ditë më parë është hapë një tender për ndërtimin e fshatit Turistik, pyetja ime është arsyeshmëria si do të dukët fshati turistik, përmes cilës kryetari përgjigjet se do të ndërtohet te ish vilat e Napredakut dhe projektin e ki pa ne TV disa herë si duket.

Moni prap i referohem Orgesit, i cili mbledhjen e kaluar ka kërkuar sqarim për kriteret te zgjedhja e Bordit të Ndërmarrjes Higjiena, sot kërkoi sqarim për mënyrën e përzgjedhjes dhe a jan përfillë kriteret e konkursit, si dhe me të Hyrat e bartura i kemi orientu mjetet buxhetore për Ndërmarrjen Higjiena kërkoi sqarim a janë krye obligimet për këtë ndërmarrje.

Kryetari-sqaron se ne e kemi një Komision të Aksionarëve që nuk paguhen, që e kanë zgjedhë një Bord të Ndërmarrjes Higjiena pa konkurs, sa ju perket të hyrave të bartura, Ministria ende nuk e ka bërë vlerësimin i cili mundëson ekzekutimin e vendimit.

Erdogan Dautaj-pyet, a do të vendoshen policët e shtrirë në rrugën e Qendrës në mënyrë që të ulet shpejtësia e lëvizjes.

Kryetari- sqaron se sipas planifikimit në muajin Qershor do të qitet shtresa e fundit e asfaltit e pastaj do ti vendosim policët e shtrimë.

Erdogan Dautaj- paraqet kërkesën për dy kyqje të reja në rrugën kryesore "Qendra" dhe përgjigja e kryetarit të Komunës ka qenë, se do ti lejojnë këto dy kyqje.( kyqjet duhet të bëhen në fshatin Carrabreg).

Drejtori i Shërbimeve Publike, Izet Zenuni-përgjigjet në pyetjet e Yllarta Thaqit, të dërgura me shkrim dhe në formë elektronike.

Për pyetjen e parë Rruga te kanali në drejtim të Pozharit është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, ne disa herë kemi ndërhy, por pavarësisht kësaj, këtë vit nuk ka planifikim as nga ne as nga Ministria, Te gropë në qendër të Deçanit-kjo do të mbyllët dhe përfundon shpejt, Te Llot Nr.3 është planifikim i vtit të kaluar kontrata, dhe kanë kaluar në Fondin rezerv, jemi në pritje që buxheti të kthehet në Komunë, kur të kthehen nga Ministria do të vazhdojmë fillimisht me procedura te tenderimit dhe me vazhdu me projektin, mirëpo kurë kthehen nuk e dijmë. Te implementimi i projektit të elektrifikimit të rrugëve kryesore në fshatra -javën e kaluar kanë përfundu në fshtatratë Kodrali, Pozhar, Dubravë dhe Llukë e ulët, kuptohet rrugët kryesore të fshatrave, fondi prej 40.000 euro nuk është kthyte nga Ministria ende vlerësimi i ligjshmërisë Të hyrat e bartura dhe si të kthehen do të vazhdojmë me punë me fazat tjera sipas projektit për elektrifikim, duke filluar nga Isniqi, Te rrëthi llotullimi te kryqi i par janë qitë pengesat te rruga qe hyn per Beleg por në rrugë kryesore nuk janë vendosë, te rrëthi në momentin që kompania i kryen punimet te Kompania Aginisi gas javën e ardhshme ka me fillu puna me ndërtim te rrëthit te ETC-ja.

Yllarta pyet përrrugën nga kanali deri te Ura e Pozharit, a ka mundesi qe te vendosen pengesat si ne Carrabreg, sepse është rrugë e rrezikshme dhe ri rezultat i kësaj kanë ndodhë shumë ndeshje.

Izeti-te rruga nga kanali deri te Ura e Pozharit, ne kemi ba analizë per ndeshjet qe kane ndodhe qe kanë ndodhë dhe kemi vendose qe te qiten pengesat, te njëjtën kerkesë e kemi ba ne ministri por nuk kemi marre përgjigje, ne momentin qe na lidhim kontrate per mirëmbajtje me kompanine do te vendosen ne ate rruge tri pengesa te njëjta si te QKMF-ja.

Hyri Dobrunaj- thot se jemi dakorduar në KPF që të sjelljet në Kuvend kërkesa e Miftar Januzaj për përkraje financiare për Muzeun Etno Kastrioti,

Kryesuesi- sqaron se te gjitha kërkesat qe nuk kane ardhe me kohë të caktuar i qesim mbledhjen e ardhshme, mirëpo si praktikë është ma mirë që kërkesat të vijnë me shkrim 5 ditë para maledhjes.

Hyri Dobrunaj- kërkon kontratën për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve, rruga "Elezaj" në fshatin Strellc kurë do të shtrohet pjesa qe është ne kompetencë të komunës së Deçanit, Kockat e rrugës së vjetër ku janë, trotuaret per gjate rrugës me katër korsi-kurë kanë me u liru, ,vendshënimet e këmbësorëve kurë do të janë të gatshme për nana me fëmij dhe persona me aftësi të kufizuar.

Florim Mataj- pyet lidhur me mbështetjen financiare për Ansamblin e Këngëve dhe valleve, pse nuk është bërë ekzekutimi i vendimit të vtit të kaluar, dhe nëse proceduralisht kërkohet të del si kërkesë edhe këtë vit kish qenë mirë me na pru si kërkesë.

Drejtoresha, Dafina-përgjigjet , meqenëse vendimi është i vtit të kaluar duhet të vjen edhe një herë si kërkesë në mënyrë që vendimi të jetë i këtij viti, pastaj e ekzekutojmë.

Miftar Ahmetxhekaj-pyet, për ndriçim publik për fshatin Isniq kurë do të rregullohet dhe rruga Qendra e qytetit prej pompes Agonisi deri te Ura e Demës a ka projekt deri te rruga e Gashit apo deri te Ura e Demës.

Drejtori, Izet-sqaron se momentin kurë të na dalin 40.000 euro të planifikuara nga Komuna menjëherë do të investojmë në ndriçimin e fshatit Isniq.

Drejtori Urbanizmit, Ramë Melaj- sqaron se projekti i ndërtimit të rrugës Qendra është prej pompës Agonisi gas deri te Ura e Demës, mirëpo ne do ta realizojmë projektin deri te rruga Isa Balaj jemi edhe në kontakt me ministrinë për këtë projekt dhe jemi në fazën përfundimtare dhe shum shpejt do të shpallet tenderi deri te rruga Isa Balaj.

Faton Selmanaj-në KPF e kam ngritë një pyetje lidhur me zbatimin e Rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në Komunën e Deçanit .

Drejtori Inspepcionit, Halil Tolaj- sqaron se rregullorja është miratu në korrik 2019, në fund të vtit kryetari e ka marrë një vendim për pezullim të rregullores përkohësisht me presion të bizneseve gjatë festave të fund vtit sepse klientat shkojshin në Pejë për blerje, kurse në mars ndodhi pandemia dhe u çrrëgullua gjithçka me përjashtim te masave te qeverise per anti kovid, ne ekonominë e tregut të lirë nuk mund te kufizohet orari i punës por këtu është mëndu qe te mbrohen punëtorët përndryshe zbatohet orai ditorë kurse orari favorë , jo.

Florim Mataj- thot se rregulloren e kemi hartu bashkarisht këtu dhe është funksionale, ndodhi pandemia dhe u pezullu, mirëpo nëse ka mangësi në zbatim e bini këtu dhe e ndryshojmë aty ku është e nevojshme.

Drejtori- thot se ka mangësi dhe problemi është se nuk mund të implementohet në teren kurë kemi parasyshë orarin e bizneseve dhe tregun e lirë, implementimi ne teren është shumë i vështirë, strikt ditën e diel vetëm barnatoret e respektojnë.

Faton Selmanaj-thot apsolusht ska të bëjë me tregun e lirë dhe a dëshiron mi zbatu ti si kryesues apo don mi qitë poshtë si rregullore.

Kryesuesi- i pyet prap si dëshironi me i parashtru pyetjet dhe kurë i doni përgjigjet, kurë bëhet pyetja a dëshironi që të inkuadrohet edhe dikush përvëç atij që e shtron pyetjen, a insiston prashtruesi i pyetjes disa here per marrje te përgjigjeve apo si do të vendosni per kete çështje, ne e kemi edhe rregulloren e punës se kuvendit, nëse mendoni bëjmë ndryshime edhe aty nëse nuk i kemi planifikuar krejt aty.

Florim Mataj- thot se e kemi një Ligj, Ligji për Vetëqeverosje Lokale , i cili sqaron se kurë bëhet pyetja dhe si ipen sqarimet, si zhvillohet debati.

Drejtori Administrates, Jashar Dobraj- thot se pajtohet me Florimin dhe këtë gjë e përcakton LVL. Ligji parashev që çdo pyetje bëhet në fillim të mbledhjes para se me u aprovua rendi i punës, përgjigja ipet në atë mbledhje në fund të mbledhjes ose mbledhjen tjeter, pyetja i drejtohet Kryetarit të komunës dhe i delegon përgjegjësitë te drejtori në fushëveprinttarinë e të cilat bie pyetja, mirëpo çdo pyetje qe vjen me kohe ne forme te shkruar apo direkt ne mbledhje duhet te trajtohet dhe ti ipet përgjigje.

Florim Mataj-kërkesa për tu futur si pikë bëhet në fillim të mbedhjes propozohet dhe votohet si pikë e veçantë, pyetjet te të ndryshme.

Orges Tafilaj- thotë në Të ndryshme i trajtojmë pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Kryesuesi-mendoj se ma mirë është me i parashtru me shkrim pyetjet përpara .

Florim Mataj- thot sikur e ka parashtru Yllarta mirë është.

Miftar Ahmetxhekaj- thot pika në rend dite futet me propozim në fillim të mbledhjes votohet si pikë, debatohet si pikë e veçantë dhe hapet debati rrith saj, ndërsa pyetjet parlementare bëhet pyetja dhe mund të ipet përgjigja aty për aty ose mbledhjen tjeter.

Kryesuesi- atëherë pyetjet kush don me shkrim e bon përpara kush don e bon ne fund te mbledhjes ose si te dëshironi ju.

Hyri Dobrunaj- thot te parashtrimi i pyetjeve, marrja e përgjigjeve dhe forma e debatit, qëllimi është mos me folë dy për njëhere se asgjë spo dëgjohet.

Kryesuesi- njofton se do të kemi mbledhje solemne me dt. 5 maj-dita kur përkujtohen heronjët, dëshmorët nga komuna e Deçanit.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Llolluni



Kryesuesi i Kuvendit  
Hajdar SUTAJ

